

V E N D I M
Nr. 210, datë 16.5.2002

PËR DHËNIE FOND NDIHME DISA PARTIVE TË REJA POLITIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Partisë të Gjelbrit e Shqipërisë, Partisë Aleanca Popullore Shqiptare, Partisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve dhe Partisë së Sigurimit Kombëtar t’u jepet, secilës, një fond ndihme prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh.
 2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2002 për partitë politike.
 3. Ngakohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko